



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 18448 prot

D.7: 14.11.2024

URDHËR

Nr. 604 / Datë 14. 11.2024

PËR “KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR APLIKIMET PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”

Bazuar në pikën 2, neni 8, ligji nr.139, datë. 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjin 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM 384, datë 15.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipa çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin Nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, VKM Nr. 454 datë 3.7.2019 për “Kriteret dhe procedurat dhe përfitimin dhe dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, VKM NR. 405 datë 1.6.2016 për “Miratimin e Strategjisë për Strehimin Social”,

URDHËROJ :

1. Të krijohet grupi i punës për aplikimet për programet sociale të strehimit.
2. Struktura përgjegjëse do të përbëhet nga përfaqësues të:
 - Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social
 - Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit
 - Drejtorisë Juridike
 - Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban
 - Drejtorisë së Emergjencave Civile
 - Drejtorisë së Administrimit të Aseteve dhe Kadastra
 - Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës.
3. Struktura e ngritur në pikën 2 të këtij Urdhëri, do të kryejë vlerësimin, verifikimin dhe hartimin e projekteve sociale të strehimit brenda afateve të caktuara nga ministria përkatëse, për hartimin e projekteve.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Pjerin Ndreu

